



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:273963

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05758598

C.nr.4803/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësve M.N., E.M., L.M. dhe A.E.F., të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson F.S., avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i shujtave, vlera e kontestit 1,336.00 euro, jashtë seance, me datë 30.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve M.N., E.M., L.M. dhe A.E.F., të gjithë nga Prizreni, në tërësi e **bazuar**.

- II. **DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditësve, ti paguaj shumat si në vijim:
 - a) Paditëses M.N. nga Prizreni, në emër të shujtave ditore, për 167 ditë pune (nga data 15.01.2022, deri më 21.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro, apo shumën e përgjithshme prej 334.00 € (treqind e tridhjetë e katër),
 - b) Paditëses E.M. nga Prizreni, në emër të shujtave ditore, për 167 ditë pune (nga data 15.01.2022, deri më 21.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro, apo shumën e përgjithshme prej 334.00 € (treqind e tridhjetë e katër),
 - c) Paditëses L.M. nga Prizreni, në emër të shujtave ditore, për 167 ditë pune (nga data 15.01.2022, deri më 21.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro, apo shumën e përgjithshme prej 334.00 € (treqind e tridhjetë e katër),
 - d) Paditëses A.E.F. nga Prizreni, në emër të shujtave ditore, për 167 ditë pune (nga data 15.01.2022, deri më 21.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro, apo shumën e përgjithshme prej 334.00 € (treqind e tridhjetë e katër).

Shuma e përgjithshme të cilën është e detyruar e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që t'ia paguaj paditësve M.N., E.M., L.M. dhe A.E.F., të gjithë nga Prizreni, në emër të kompensimit të shujtave ditore, të cekura në pikë a), b), c) dhe d), të këtij dispozitivi është

1,336.00 € (njëmijë e treqind e tridhjetë e gashhtë euro), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **290.00 € (dyqind e nëntëdhjetë euro)**, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit M.N., E.M., L.M. dhe A.E.F., të gjithë nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre F.S. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, përmes shërbimit postar me datë 09.12.2023, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimin shujtave ditore, vlera e kontestit 1,336.00 euro.

I autorizuari i paditësve, në padi ka theksuar se paditësit janë të punësuar te e paditura, në bazë të kontratës së punës Mësimdhënës në institucionin arsimor në SHFMU "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në fshatin Mazrek, komuna e Prizrenit dhe të njëjtëve bazuar në nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të vitit 2021, i takon e drejta për kompensim për ushqim dhe atë nga 2 euro, për do ditë të pranisë në punë. Përkatësisht paditësve gjatë periudhës kohore nga data 15.01.2022, e deri me datë 21.11.2022, i takon kompensimi për ushqimin ditor për 167 ditë pune, apo nga 334.00 euro. E paditura gjatë periudhës së lartcekur, paditësve nuk ia ka bërë kompensimin për ushqim gjatë ditëve të pranisë në punë dhe për këtë arsye paditësit me datë 10.02.2023, të paditurës i janë drejtuar me kërkesë me shkrim për kompensimin e këtyre mjeteve, mirëpo e paditura deri në parashtrimin e padisë nuk i ka përmbushur obligimet e saj ndaj paditësve. Andaj, Gjykatës i ka propozuar, që e njëjta të merr aktgjykim dhe kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

E paditura, përmes të autorizuarës së saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës. Ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488, të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar. Tutje ka shtuar se pretendimet e paditësve se i takon kompensimi i shujtave ditore është në kundërshtim me nenin 2 par.1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, pasi përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtar i sindikatës. Të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1

dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënës pranë SHFMU "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", në fshatin Mazrek, komuna e Prizrenit.

Gjykata përmes vërtetimit të datës 08.02.2023, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHFMU "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", në fshatin Mazrek, komuna e Prizrenit, kontratës së punës me numër të protokollit 63/17, vërtetoi faktin se paditësja M.N. është në marrëdhënie pune në këtë shkollë dhe gjatë periudhës prej datës 15.01.2022 deri me 21.11.2022, ka punuar gjithsej 167 ditë pune.

Gjykata përmes vërtetimit të datës 08.02.2023, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHFMU "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", në fshatin Mazrek, komuna e Prizrenit, kontratës së punës me numër të protokollit 66/17, vërtetoi faktin se paditësja E.M. është në marrëdhënie pune në këtë shkollë dhe gjatë periudhës prej datës 15.01.2022 deri me 21.11.2022, ka punuar gjithsej 167 ditë pune.

Gjykata përmes vërtetimit të datës 08.02.2023, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHFMU "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", në fshatin Mazrek, komuna e Prizrenit, kontratës së punës me numër të protokollit 74/18, vërtetoi faktin se paditësja L.M. është në marrëdhënie pune në këtë shkollë dhe gjatë periudhës prej datës 15.01.2022 deri me 21.11.2022, ka punuar gjithsej 167 ditë pune.

Gjykata përmes vërtetimit të datës 08.02.2023, të lëshuara nga ana e drejtorit të SHFMU "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", në fshatin Mazrek, komuna e Prizrenit, kontratës së punës me numër të protokollit 58/17, vërtetoi faktin se paditësja A.E. është në marrëdhënie pune në këtë shkollë dhe gjatë periudhës prej datës 15.01.2022 deri me 21.11.2022, ka punuar gjithsej 167 ditë pune.

Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *"Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të"*.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e datës

22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit, nr.01/B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë "Të punësuarve (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...".

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: "Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.", pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditësve si punëtor të arsimit-mësimdhënës, t'ia paguaj kompensimin e shujtave, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, neni 35 paragrafi 7, pasi që për paditëset M.N., E.M., L.M. dhe A.E.F., të gjithë nga Prizreni, kërkesa është bërë e arritshme për secilën nga 167 ditë pune, apo shuma prej 334.00 €, për secilin paditës veç e veç.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritator. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi kërkesëpadinë e paditëses sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë shumë prej 260.00 euro dhe taksës gjyqësore shumë prej 30.00 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme 290.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.4803/2023, datë 30.05.2024

G j y q t a r i

Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.